

RENDI I DITËS

Hedhja e shortit “Për caktimin e relatorëve të kërkesave ankimore nr. 29, 30, 31”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema.**

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot, në datën 12.03.2023 do të zhvillohet procedura e shortit për caktimin e relatorit, për kërkesat ankimore nr. 29, 30 dhe 31. Pranë KQZ-së janë paraqitur 3 kërkesa ankimore 29, 30, 31. Kërkesa Ankimore nr. 29 me kërkues Partia Demokratike, Kërkesa Ankimore nr. 30 me kërkues partia politike “Lëvizja Bashkë” dhe Kërkesa Ankimore nr. 31 me kërkues Partia Demokratike e Shqipërisë. Përpara se të zhvillohet seanca e shortit për caktimin e relatorit sipas nenit 14 të rregullores së KAS-it, kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në tre janë shënuar kërkesat ankimore nr. 29, 30, 31 të cilat do të futen në 5 gogla me peshë , ngjyrë dhe formë të njëjtë. Një përfaqësues i KQZ-së, do të palosë fletët, pasi ti shfaqë në kamera. Më pas fletët do futen në gogla. Goglat më pas do të futen në një enë transparente. Dy shiritat e fundit janë të bardhë dhe pa shënime. Duke qenë se anëtarët e Kas-it nuk janë prezent, sipas nenit 14 një përfaqësues i KQZ-së do të përzije goglat në emër dhe për llogari të tyre duke filluar nga rendi alfabetik ngjitës. Emri i parë është zoti Elvin Lako.

Për Z. E. Lako: Tërhiqet gogla – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Për Z. E. Çefa: Tërhiqet gogla – Kërkesa Ankimore nr. 30.

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.03.2023*

Për Z. I. Rusmali: Tërhiqet gogla - Kërkesa Ankimore nr. 29.

Për Z. K. Bele: Tërhiqet gogla – Kërkesa Ankimore nr. 31.

Për Z. L. Braho: Tërhiqet gogla - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit relator i Kërkesës Ankimore nr. 29, është zoti Ilirjan Rusmali, relator i Kërkesës Ankimore nr. 30, është zoti Elvis Çefa dhe relator i Kërkesës Ankimore nr. 31, është zoti Koli Bele. Me kaq përfundoi procedura e shortit, ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

